



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 938/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 102-të, të mbajtur më 14.07.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohet** programi i studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
 1. *Mjekësi Klimike, PhD*, 180 ECTS, maksimumi 10 studentë për vit akademik.
- II. **Nuk akreditohet** programi i studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:
 1. *Stomatologji, PhD*, 180 ECTS.
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Mjekësi Klinike, PhD, 180 ECTS, Riakreditim	Shemsedin Dreshaj Shpend Elezi Cen Bytyqi Ibrahim Rudhani Serbeze Kabashi-Muçaj
2.	Stomatologji, PhD, 180 ECTS, Riakreditim	Agim Begzati Gloria Staka Blerim Kamberi Kujtim Shala Hidajet Paçarizi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me këtë përbërje: Joke Denekens, Luc Hittinger, Mihaly Boros, Adrian Stan dhe Jadranka Pelikan. Vizitat janë organizuar në datat: 31.05.2022 dhe 15.06.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës, ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Mjekësi Klinike, PhD, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush 36 standarde thelbësore dhe 13 standarde plotësuese të akreditimit.
2. Për programin e studimit *Stomatologji, PhD, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush 29 standarde thelbësore dhe 11 standarde plotësuese të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 102 të mbajtur më 14.07.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit, të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Ass. Dr. Hasnë Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

